



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	12-05-2021	viti god year	
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	2376	2021	1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.265/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3000/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.647/2019 të datës 23.10.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Remzi Hoxha” Kinemaja e Re, kati 7, Nr.23, Ferizaj, kundër Vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Ferizajt Nr.02-111/01-0114417 të datës 14.10.2019, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 48 dhe nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.647/2019 e datës 23.10.2019, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.02-111/01-0114417/2019 i datës 14.10.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt.

A r s y e t i m

Komuna e Ferizajt, me datën 22.07.2019 ka shpallur konkursin me Nr.01/151/19 për pozitën “Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve”, në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe i njëjti ka marrë pjesë në të gjitha fazat e kësaj procedure rekrutimi, por që nuk ka arritur të zgjidhet si kandidat i suksesshëm sipas Njoftimit Nr.01-171/19 të datës 13.09.2019. Ankuesi i pakënaqur me këtë Njoftim me datë 18.09.2019 ka parashtruar ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajt.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Ferizajt, me Vendimin e datës 14.10.2019 me Nr.02-111/01-0114417/2019, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi kundër vendimit më Nr. 02-111/01-0114417/2019 të datës 14.10.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt, më datë 23.10.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.10.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Komuna e Ferizajt. Ndërsa Këshilli më datë 01.11.2019, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Ferizajt se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'arsye Këshilli me shkresën me numër protokoll 5425/2019 të datës 18.11.2019, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.647/2019 të datës 23.10.2019, duke udhëzuar të njëjtin për të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.3000/2019 të datës 01.04.2021, i pranuar në Këshill më datë 08.04.2021, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.11.2019 dhe ka detyruar Këshillin që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 23.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4988/2019 të datës 23.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.02-111/01-0114417/19 i datës 14.10.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Ferizajt; Njoftimi i datës 13.09.2019 për kandidatin e suksesshëm; Konkurs i datës 22.07.2019 me nr.01-151/19; Njoftimi i datës 26.08.2019 për mbajtjen e intervistës me gojë; Kopja e letërnjoftimit; Pliko me numër R7584948 e datës 21.10.2019; Akt përcjellës i datës 01.11.2019; Autorizimi i MAP-it i datës 16.07.2019; Vendimi i datës 09.08.2019 për formimin e Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Civil; Finalizimi i Listës së ngushtë; Regjistri i aplikacioneve të pranuar i datës 06.08.2019; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 31.07.2019; Kërkesa për punësim e datës 31.07.2019 për
Diplomë me numër nr. 708/0610 i datës 21.06.2010; Certifikatë e datës 01.04.2019; Aplikacioni për punësim i
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile i datës 16.07.2019; Certifikatë e datës 02.02.2017 deri 18.04.2017; Certifikatë datës 01.07.2009 deri 31.07.2009; Certifikatë e datës 27.05.2009; Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për kontrollor i datës 28.02.2011; Zyra e Regjistrimit të Popullsisë Flete rekomandim i datës 27.11.2011; Certifikatë e datës 03.11.2008 deri 27.02.2009; Diplomë me numër nr.1586 i datës 11.12.2018; Testi me shkrim i kandidatës
Testi me shkrim i kandidatit

Raporti final i rekrutimit nga komisioni rekrutues i datës 09.07.2019; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 26.07.2019; Kërkesa për punësim e datës 26.07.2019 për

Marrëveshje për Shërbime të Veçanta që i nënshtrohet ligjit të detyrimit prej datës 01.06.2018 deri 30.11.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta që i nënshtrohet ligjit të detyrimit prej datës 04.02.2019 deri 31.07.2019; Certifikatë e datës 26.07.2019; Certifikatë e datës 01.08.2015; Certifikatë e datës 04.11.2016; Vërtetim i datës 03.06.2016; Certifikatë prej datës 13.02.2017 deri 03.03.2017; Certifikatë e datës 10.04.2014; Kopja e letërnjoftimit; Diplomë me numër nr.131/16 i datës 13.02.2016; Përgjigje në ankesë e datës 01.11.2019 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/63; E-

mail nga C.Z. për F.V. i datës 19.04.2021; E-mail nga F.V. për C.Z. i datës 20.04.2021; Njoftim për testin me shkrim i datës 19.08.2019; Njoftim i kandidatëve të cilët kanë marrë pjesë në testin përfundimtar lidhur me rezultatin e pikëve të shprehura në përqindje i datës 13.09.2019; ankesa me numër A.nr.647/2019 e datës 23.10.2019, e parashtruar nga ankuesi si dhe ankesën A.nr.265/2021 të datës 08.04.2021 sipas Aktgjykimit A.nr.3000/19; Njoftim me numër protokolli 5425 i datës 18.11.2019; Flet kthesë e datës 25.11.2019;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka administruar provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Në ankesën e parashtruar në Këshill, ankuesi pretendon se vendimi i atakuar me ankesë është nxjerrë më shkelje të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Me tutje shton se Komisioni Përzgjedhës nuk ka njoftuar kandidatet me rezultatet përfundimtare si dhe nuk ka bërë vlerësimin real dhe të drejtë të ankuesit. Kërkon që Këshilli ta anuloj Vendimin Nr.02-111/01-0114417/2019 të datës 14.10.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Ferizajt si dhe Njoftimin e datës 13.09.2019 për kandidatin e suksesshëm.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kritere themelore të konkursit Nr.01/151/19 të datës 22.07.2019 për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve", në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, të Komunës së Ferizajt kanë qenë:

- *Diplomë Universitare Fakulteti Ekonomik, drejtimi: Banka Financa dhe Kontabilitet, Menaxhment dhe Informatikë, Ekonomi e aplikuar dhe Menaxhment + 0 vite përvojë pune apo; Shkolla e Lartë + 2 vite përvojë pune.*

Bazuar në vlerësimin e shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar së Komuna e Ferizajt me datë 22.07.2019ka shpallur konkursin me Nr.01/151/19 për pozitën "Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve", në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, në të cilin konkurs kanë aplikuar 55 kandidatë, në listën e shkurtër të datës 13.08.2019, janë përfshirë 51 kandidatë të cilët janë ftuar për në testin më shkrim të mbajtur me datë 22.08.2019, ndërsa në intervistë gojore janë ftuar 34 kandidatë. Sipas shkresës me numër 01-172/2019 të datës 13.09.2019, është bërë njoftimi i kandidatëve pjesëmarrës lidhur me rezultatet e pikëve, e shpallur në Tabelën e shpalljeve publike të Komunës së Ferizajt, ndërsa me shkresën me numër 01-171/2019 të datës 13.09.2019 është bërë njoftimi për kandidaten e suksesshme e vlerësuar me gjithsej 93.2% të pikëve.

Përkitazi me plotësimin e kriterëve të konkursit nga kandidatja e zgjedhur

Kolegji nga shqyrtimi i dosjes së aplikimit të kandidatës së zgjedhur, ka konstatuar se e njëjta ka plotësor kushtet e përcaktuara me konkurs, respektivisht posedon Diplomë të Kolegjit AAB me numër 131/16 të datës 13.02.2016 më të cilën dëshmohet së ka te përfunduara studimet themelore universitare në programin për Banka, Financa dhe Kontabilitet, si dhe ka prezantuar edhe përvojë si Zyrtare e Tatimit në Pronë në Drejtorinë e Financave të Komunës së Ferizajt nga data 01.06.2018 deri 30.11.2018 dhe nga data 04.02.2019 deri 31.07.2019, e punësuar në bazë të Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta.

Lidhur me pretendimin ankimor së kandidatët nuk janë njoftuar me shkrim lidhur me rezultatet pas testimit përfundimtar, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se njoftimin i

kandidateve me rezultatet e pikëve është bërë përmes shkresës së datës 13.09.2019 me numër 01-172/2019 e shpallur në tabelën e shpalljeve të Komunës së Ferizajt, e si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafi 1 të Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, ku është përcaktuar se: *Të gjithë kandidatet e ftuar në përzgjedhjen dhe testimin përfundimtar informohen me shkrim për rezultatin.....*” e mbi këtë bazë rezultoni se përfundimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Sipas shkresës 01-172/19 të datës 13.09.2019 si dhe njoftimit 01-171/19 të datës 13.09.2019, kandidatja është vlerësuar si kandidatja me suksesshëm për pozitën “Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve”, me 93.2% pikë, ndërsa ankuesi me gjithsej 74%, andaj, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civilë ku është përcaktuar se: *në Shërbimin Civilë emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe gojë, e në këtë kuptim, pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me vlerësim jo të drejtë është i pabazuar.*

Duke ju referuar rrethanave dhe fakteve si me lartë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve”, në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, të Komunës së Ferizajt, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* si dhe dispozita e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A nr.265/2021;

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

